VENDIM
Nr. 287, datë 13.11.2025

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "INFOTELECOM-ALBSOLAR 4" SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa "a", 38, pika 1, germa "a", 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa "a", 5, pika 1, germa "a", 13 dhe 14, pika 9 të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.11.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2207/16 prot., datë 10.11.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Infotelecom-Albsolar 4' sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "Infotelecom-Albsolar 4" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2207 prot., datë 30.7.2025, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 35.6 mw, me vendndodhje në rrugën "Gjorica e Poshtme", Njësia Administrative Gjoricë, Bashkia Bulqizë, qarku Dibër.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 191, datë 12.8.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 13.8.2025 dhe 14.8.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve, apo objeksioneve nga të tretët (data 11.9.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua në rrjetet sociale dhe në faqen e internetit të ERE-s.
- Me shkresën nr. 2207/3 prot., datë 14.8.2025, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e fillimit të procedurës dhe i ka kërkuar depozitimin e informacionit/dokumentacionit të aplikimit të konstatuar të paplotësuar, ose të plotësuar pjesërisht.
- ERE, po ashtu, ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, nëpërmjet shkresës nr. 2207/4 prot., datë 14.8.2025, ku po ashtu i ka kërkuar të bëjë me dije nëse nga ana e saj ka një qëndrim ndryshe, në lidhje me vlefshmërinë e kontratës dhe të drejtën e shoqërisë për ndërtimin dhe shfrytëzimin e këtij burimi gjenerues. Nga ana e MIE-s nuk ka pasur kthim përgjigjeje.
- Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2207/5 prot., datë 9.9.2025, ka depozituar një pjesë të informacionit/dokumentacionit plotësues, nga shqyrtimi i të cilit është parë e nevojshme zhvillimi i një seance dëgjimore për arsye të sqarimit të mëtejshëm të dokumentacionit të munguar. Ndaj ERE me shkresën nr. 2207/7 prot., datë 17.9.2025, i është drejtuar shoqërisë, duke i njoftuar zhvillimin e seancës dëgjimore.
- Në datën 22.9.2025 është zhvilluar seanca dëgjimore në ambientet e ERE-s ndërmjet përfaqësuesve të ERE-s dhe të shoqërisë "Infotelecom-Albsolar 4" sh.p.k., të cilët, në vijim të seancës morën angazhimin për të plotësuar dokumentacionin e munguar, brenda afatit të përcaktuar.
- Me *e-mail*-in e protokolluar në ERE me nr. 2207/8, datë 24.9.2025, shoqëria i është drejtuar MIE-s, duke vënë në dijeni ERE-n, në lidhje me marrjen e konfirmimit zyrtar, apo shkresë formale

mbi nënshkrimin e Marrëveshjes Përfundimtare dhe Marrëveshjes së Mbështetjes nga MIE. Duke qenë se ky *e-mail* nuk shteronte sa kërkohet dhe marrë angazhim nga shoqëria gjatë seancës dëgjimore, ERE i është drejtuar me *e-mail*-in me nr. 2207/9 prot., datë 1.10.2025, duke i bërë me dije sa më sipër, si dhe duke i rikujtuar detyrimin për depozitimin e dokumentacionit.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2207/10 prot., datë 1.10.2025, shoqëria ka depozituar një pjesë të dokumentacionit, nga analizimi i të cilit rezultoi se ishte ende i nevojshëm zhvillim i një komunikimi të mëtejshëm mbi dokumentacionin e mbetur ende pa plotësuar.
- Si e tillë, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 254, datë 14.10.2025, vendosi të zgjasë vendimmarrjen për licencimin e shoqërisë. Ky vendim iu njoftua shoqërisë nëpërmjet shkresës së ERE me nr. 2207/12 prot., datë 20.10.2025, me anë të së cilës i është kërkuar dhe depozitimi i dokumentacionit të sipërcituar.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2207/13 prot., datë 27.10.2025, shoqëria ka depozituar një pjesë të dokumentacionit të kërkuar, nga analizimi i të cilit u pa i nevojshëm zhvillimi i një komunikimi të mëtejshëm, në lidhje me nënshkrimin e Marrëveshjes Përfundimtare me MIE-n, ndaj ERE-s iu drejtua përsëri shoqërisë nëpërmjet *e-mail*-it nr. 2207/14 prot., datë 4.11.2025.
- Së fundi, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2207/15 prot., datë 4.11.2025, shoqëria ka depozituar dokumentacion dhe informacion, në lidhje me nënshkrimin e marrëveshjes përfundimtare.
- Nga analizimi i këtij aplikimi, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar nga rregullorja "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera:

- Shoqëria ka nënshkruar me MIE-n "Marrëveshjen për zhvillimin e projektit, në lidhje me projektimin, financimin, ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e impiantit fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 35,6 mwac dhe Kapacitet të Mbështetur 35,6 mwac, që do të vendoset në Bashkinë Bulqizë, rruga 'Gjoricë e Poshtme', Shqipëri", të datës 4.12.2024.
- Ka nënshkruar "Marrëveshjen për lidhjen me rrjetit e transmetimit të parkut fotovoltaik "Gjorica Solar Park", me OST sh.a., datë 29.7.2025.
- Shoqëria është pajisur me vendim për VNM paraprake, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), më 17.9.2025, për të zhvilluar projektin: "Projekti fotovoltaik Gjorica Solar Park 40 mw", me vendndodhje në Bashkinë Bulqizë. Kjo VNM është e vlefshme deri më 17.9.2027.

Kushtet dhe afatet ligjore

ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa "a" të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, germa "a" të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Shoqëria ka depozituar garancinë 30-vjeçare të performancës për panelet fotovoltaike, ndaj dhe afati i licencës vlerësohet që të jetë për 30 vjet.

- Rezulton se shoqëria ka nënshkruar marrëveshjen e zhvillimit me MIE-n dhe nuk ka nënshkruar ende marrëveshjen përfundimtare, ndaj, referuar vetë parashikimit të shoqërisë që do të vendosë në operim centralin më datë 1.10.2026, vlerësohet që t'i lihet asaj kusht që të raportojë në ERE, në lidhje me ecurinë e nënshkrimit të marrëveshjes përfundimtare brenda dhe të fillojë operimin brenda datës së parashikuar nga ana e saj.

- Po ashtu, në referencë të sa parashikohet në pikën 6.8 të marrëveshjes së zhvillimit të nënshkruar me MIE-n, në lidhje me procedurën e kolaudimit të veprës, vlerësohet që t'i lihet kusht shoqërisë që me fillimin e operimit, por jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga ky fakt, të dokumentojë në ERE kolaudimin e veprës, si dhe të depozitojë informacion të përditësuar, në lidhje me stafin teknik efektiv në strukturën e saj organizative.

- ERE rezervon të drejtën e rishikimit të këtij vendimi në rast të depozitimit të sa lënë detyrë shoqërisë dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.

- Në përfundim, vlerësohet se shoqëria ka përmbushur kushtet për licencim, me detyrimin për të respektuar afatet dhe detyrimet e përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Infotelecom-Albsolar 4" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 35.6 mw, me vendndodhje në rrugën "Gjorica e Poshtme", Njësia Administrative Gjoricë, Bashkia Bulqizë, qarku Dibër, për një afat 30-vjeçar.

2. Brenda datës 1.10.2026, shoqëria duhet të raportojë në ERE, në lidhje me nënshkrimin e marrëveshjes përfundimtare me MIE-n dhe të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike.

3. Me fillimin e operimit, por jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga ky fakt, shoqëria duhet të dokumentojë në ERE kolaudimin e veprës dhe të depozitojë informacion të përditësuar, në lidhje me stafin teknik efektiv në strukturën e saj organizative.

4. Ky vendim është objekt rishikimi, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushtit të pikave 2 dhe 3 të këtij vendimi dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.

5. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "Infotelecom-Albsolar 4" sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, OST sh.a. dhe ALPEX sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti